

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E ENJTE 12 MAJ 2022

Zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Akti që na propozon sot qeveria e Edi Ramës për t'u votuar përbën një hipokrizi të nivelit më të lartë, jo për shkak të përmbajtjes së këtij akti, sepse akti në përmbajtjen e tij është ratifikim i një protokollit të Konventës së Mbrojtjes të Individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave, respekton privatësinë dhe mbron të dhënat personale në parim, ajo që përbën hipokrizi është fakti që na sjellin një ratifikim protokollit për mbrojtjen e të dhënave, por ndërkohë kush e sjell? E sjell kjo qeveri dhe ky Kryeministër që të dhënat e 1 milion shqiptarëve i nxori sheshit dhe i përdori për të shantazhuar, për të kërcënuar, për të rrëmbyer votat dhe për gjithçka, vetëm jo në shërbim të qytetarëve.

Pra, ky akt është hipokrizi e gjallë, sepse na vendos përpara një ligj, për të cilin këta që na e kanë sjellë janë kapur në flagrancë, duke e shkelur dhe duke e dhunuar. Ligji që na propozojnë sot për t'u miratuar është thjesht për disa ndryshime në këtë konventë dhe sigurisht që ligji i mbron akoma më mirë teorikisht të dhënat personale të individit, mbron përkatësinë politike, racore, fetare e të tjera, por me pak fjalë ky ligj është antipatronazhist. Sot po na e paraqesin neve, por kush e sjell për miratim dhe kush është partizania e miratimit të këtij ligji? Është qeveria e patronazhistëve, grupi i patronazhistëve që rrëmbyen dhe vodhën votat e shqiptarëve. Pra, teorikisht ky ligj është ligj kundër njërit prej krimeve më të mëdha të Edi Ramës dhe të qeverisë, është një ligj kundër vjedhjes për qëllime politike të të dhënave personale të zgjedhësve shqiptarë.

A mund të ketë një njeri sot në Shqipëri, që ta ketë kaluar 25 prillin e vitit të kaluar dhe të besojë që Edi Rama dhe ushtria e tij, hordhitë e tij, nuk do ta shkelin këtë konventë që po miratohet sot sapo të afrojnë zgjedhjet? As militanti më radikal socialist nuk e beson. Pra, ky akt është një hipokrizi e rëndë përmes së cilës qeveria e Edi Ramës tallet me shqiptarët. Kjo qeveri dhe Edi Rama duhet të ndajnë një gjë sot, ose të jenë pro konventës që do të miratojmë, ose t'i rrinë krenarisë së tyre për sistemin patronazhist, sistem që shkatërron të dhënat dhe mbrojtjen e çdo qytetari, nga pushteti, duke e vënë

gjatë gjithë kohës nën kërcënimin dhe rrezikun e pushtetit. Besoj se sot është koha të kujtojmë mburrjen që Edi Rama bënte para shqiptarëve, patronazhistëve dhe sistemit të patronazhistëve.

Kjo konventa e sotme kur paraqitet dhe mbrohet nga qeveria e Edi Ramës nuk është as më shumë e as më pak vetëm hipokrizi dhe tallje me qytetarët e këtij vendi. Shqiptarët e kanë parë me sytë e tyre sot e 1 vit më parë se si Edi Rama krijoi rreth 1 milion dosje për 1 milion shqiptarët që do të votonin, duke u vjedhur atyre të dhënat personale: numra telefoni, numra kartash identiteti, preferenca partiake, paga, targa makinash, llogari bankare rrjedhëse, ato janë në duart e partisë në pushtet, për ta frikësuar dhe shantazhuar votuesin, për të blerë votën dhe për ta rrëmbyer atë dhe kjo qeveri i përdor për të ruajtur pushtetin. Pra, kjo maxhorancë e ka grisur këtë konventë pa e sjellë fare për votim dhe miratim.

Në këtë tallje që u është bërë shqiptarëve, në fakt, Edi Rama nuk është i vetëm, sepse vetë nuk mund ta varroste dot këtë masakër zgjedhore që u zhvillua në këtë vend më 25 prill. Rama për ta zhvilluar këtë masakër pati edhe aleatë, sepse ky skandal ose ky megaskandal nuk u denoncua asnjëherë nga opozita, thjesht ishte një portal Lapsi.al që e denoncoi dhe ngriti alarmin rreth këtij megaskandali. Çfarë ndodhi? SPAK-u në vend që të hetonte rrjedhjen e këtyre të dhënave, keqpërdorimin nga ana e Edi Ramës dhe të qeverisë të këtyre të dhënave, iu turr zyrave të Lapsi.al, a thua sikur aty kishte ndodhur një krim i madh ndërkombëtar, por opozita heshti dhe ky krim zgjedhor nuk u hetua asnjëherë. U bë presion nga disa deputetë të Partisë Demokratike për të ngritur një komision hetimor për këtë masakër zgjedhore për çështjen e patronazhistëve, por ky komision, siç e mbani mend, u asgjësua, u zhduk.

Nuk pati asnjë raport dhe asnjë përfundim. Toni Gogu, nëse do të ishte këtu, mund të na kishte bërë një sqarim se pse u mbyll ky komision. Çfarë pyetjesh përvëluese bëri ai? Çfarë plagësh hapi? Çfarë ndodhi? Pastaj u bë një marrëveshje shumë e fshehtë: Rama-Basha, dhe Enkelejdi e Gazi e varrosën komisionin hetimor të zgjedhjeve, së bashku me të u varros masakra elektorale e 25 prillit; u varros edhe çështja e patronazhistëve. U tret si kripa në ujë Komisioni Hetimor për Zgjedhjet, i cili do ta nxirrte masakrën e patronazhistëve në sy të shqiptarëve dhe para ligjit. Faktet, duam apo nuk duam ne, janë kokëforta dhe nuk mund të anashkalohen. SPAK-u nuk lëvizi pastaj, sepse kishte dakordësinë që kjo çështje të asgjësohej. Dikush urdhëroi; dikush heshti; dikush zbatoi dhe masakra zgjedhore e 25 prillit u mbyll dhe kaloi në arkiva; çështja e patronazhistëve u mbyll e u dyllos dhe sot kjo qeveri ka guximin të vijë këtu e të na sjellë ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Pra, ka një gjë, para se të vijë ky ligj, krimet zgjedhore duhen rrëfyer; ato nuk mbyllen. Përgjegjësia penale për të gjithë ata që urdhëruan këtë masakër zgjedhore nuk është kurrë vonë të zërë vend. Faleminderit!